



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 23 shkurt 2016, në mbledhjen XXII – të (njëzetedy) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti Bahri Selimi, Shaban Osmani, Radisav Perović, Xhafer Ademi, Mefail Rama dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Enver Aliu, Policia Kufitare, Skender Shatri OSBE dhe Aron Magony, KFOR, LMT.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstrakteve të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 3 mars 2016**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### **3. Propozimi i Planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunën e Podujevës për periudhën 2016 – 2020**

##### **- Ngritja e Grupit për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit**

**z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e paraqiti fjalën hyrëse.**

Pas fjalës hyrëse, z. Liman Zeqiri shtoi, në bazë të analizave që i kam bërë duke u mbështetur në fushat apo shtyllat e rëndësishme të përfshira në këtë Plan, propozoj që në Grupin për zbatimin e këtij dokumenti të përfshihen:

Lëmia e Arsimit, z. Agim Blakçori,

Lëmia e Shëndetësisë, z. Makfire Zeka,  
Lëmia e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale, z. Ali Podvorica,  
Nga OJQ " Qëndrimi " dhe njëherit anëtar i këtij Komiteti, Xhafer Ademi,  
Përfaqësuesi i komunitetit rom, njëheri anëtar i këtij Komiteti, Mefail Rama.  
Jam i vetëdijshtëm se ngritura e këtij grupei është kompetencë dhe përgjegjësi e këtij Komiteti, mirëpo bazuar në përvojën time në këtë fushë e kam konsideruar të nevojshme ndihmën time në këtë aspekt.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, jam i mendimit se z. Liman Zeqiri, duke u bazuar në përvojën dhe njohuritë e tij dhe punën e bërë në hartimin e këtij Plani, propozimin e bëri për personat të cilët mund të kontribuojnë më së shumti për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij dokumenti, andaj e mbështes propozimin e paraqitur.  
Konsideroj se ngritura e këtij Grupi nuk duhet të bëhet vetëm formalisht por së pari jam i mendimit që mbikëqyrja e zbatimit të këtij Plani duhet të jetë serioze dhe së dyti që në këtë grup të përfshihet edhe një anëtar i këtij komiteti nga radhët e komunitetit shumicë.

**z. Shabn Osmani**, theksoi, pajtohem plotësisht me propozimin e z. Liman Zeqirit ngase personat e propozuar janë të qëlluar dhe secili mund të jep kontributin e vet në lëmin përkatës.  
Sa i përket propozimit të parafolësit që në këtë Grup të përfshihet edhe një anëtar i këtij Komiteti nga radhët e komunitetit shumicë, jam i mendimit se nuk ka nevojë të zgjerohet përbërja e këtij Grupi nga arsyaja se komuniteti shqiptar është i përfaqësuar mjaftueshëm nga anëtarët e propozuar të Shërbimit civil të komunës.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, pajtohem se përbërja e këtij Grupi prej 5 anëtarëve është e mjaftueshme por jam i mendimit se ky dokument, në vijë zyrtare, është hartuar nga ky Komitet, andaj është plotësisht e arsyeshme që në mbikëqyrje të zbatimit të këtij Plani të jetë edhe një anëtar i këtij Komiteti nga radhët e komunitetit shqiptar dhe në këtë aspekt propozoj që në përbërje të këtij Grupi të jetë Shaban Osmani ose Xhevdet Beselica.

Pas propozimeve u konstatua se Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunën e Podujevës për periudhën 2016 – 2020, njëzëri u ngritë në përbërje:

1. Xhafer Ademi, kryesues
2. Bahri Selimi, anëtar
3. Xhevdet Beselica, anëtar
4. Mefail Rama, anëtar
5. Agim Blakçori, anëtar
6. Makfire Zeka, anëtar
7. Ali Podvorica, anëtar

Grupi punues është i obliguar që në periudha të caktuara, sipas Planit të punës, Komitetit për Komunitete t'i paraqet Informatë për realizimin e Planit të cekur.

#### **4. Ngritja e Grupit punues për:**

- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë.
- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Ali Ajeti” në Podujevë.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, propozoi që vizita në lagjet e cekura të bëhet mundësish nga të gjithë anëtarët e këtij Komiteti.

Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.

Gjithashtu u vendos që vizita të bëhet më 07.04.2016 duke filluar nga ora 11.00'.

#### **5. Të ndryshme**

**z. Shaban Osmani**, theksoi, sa unë jam në dijeni se komuna e Podujevës ka përfituar pak për të mos thënë fare ndonjë donacion nga Ministria për Komunitetet dhe Kthim, andaj në këtë kontekst do duhej që të përgatiten projektet konkrete të cilat ndërlidhen me komunitetet pakicë dhe t'i dërgohen ministrisë së cekur.

Propozimi i parafolësit u miratua njëzëri.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.35'.**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Faik Gashi**

**Nr. 01-006-29534**  
**Podujevë,**  
**23 mars 2016**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Shaban Ahmeti**